

17 korrik 2007

## **Komunikatë për media**

### **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën e 28-të të Privatizimit**

**PRISHTINË** – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) të mërkurën me 18 korrik, 2007 zyrtarisht shpalli valën e 28-të të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 5 korrik, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitetet përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, [www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org)

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës 28-të janë përfshirë 10 Ndërmarrje Shoqërore nga të cilat janë krijuar 14 Ndërmarrje të Reja.

Të gjitha Ndërmarrje Shoqërore do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt.

**Afati për parakualifikim është deri në ditën e mërkurë, 12 shtator 2007.**

**Data për dorëzimin e ofertave është dita e mërkurë, 19 shtator 2007.**

\*\*\*\*\*

Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të ndërmarrjeve:

**[Ndërmarrja e Re 17 Nëntori Shitorja në Ferizaj Sh.P.K.](#)** - hapësira e kësaj Ndërmarrje të Re ndodhet në katin përdhese, në objektin buzë rrugës përball hotelit Luboten në rrugën Dëshmorët e Kombit në Ferizaj dhe përbëhet prej sipërfaqes së përgjithshme prej përafërsisht 90 m<sup>2</sup>.

**[Ndërmarrja e Re 17 Nëntori Shitorja në Lypjan Sh.P.K.](#)** - kjo ofertë përmban një shitore të vetme duke përfshirë bodrumin (91 m<sup>2</sup>) dhe katin përdhese (145 m<sup>2</sup>) dhe përbëhet prej sipërfaqes së përgjithshme prej përafërsisht 236 m<sup>2</sup>. Shitorja ndodhet në rrugën Gjergj Fishta afër qendrës së qytetit të Lypjanit.

**[Ndërmarrja e Re shitoret në Shtëpinë Bardhë Sh.P.K.](#)** - ofron mundësi për blerjen e shtatë shitoreve, që ndodhen në ndërtesën e Shtëpisë së bardhë në rrugën e Nerodimes të Ferizajt. Sipërfaqja e përgjithshme e shitoreve është përafërsisht 224 m<sup>2</sup>.

**[Ndërmarrja e Re Fabrika e Tekstilit Letnica Sh.P.K.](#)** - ofron investitorëve një fabrike prej përafërsisht 3 ha me hapësirë prodhuese dhe ndihmese që mbulojnë sipërfaqe prej përafërsisht 3,200 m<sup>2</sup>. Ky vend gjendet në Letnice, Komuna e Vitisë. Asetet e lëvizshme që i transferohen Ndërmarrjes së Re janë kryesisht makinat industriale për qepje.

**Ndërmarrja e Re Letnica Prona në Viti Sh.P.K.** - ofron investitorëve te interesuar objekte te ndryshme te vendosura ne Viti dhe ne afërsi te saj: një vend prej përafërsisht 6 ari me objekt për prodhimtari dhe një për administratë prej përafërsisht 430 m<sup>2</sup>, sikurse edhe dy shitore ne qendër te Vitisë. Asetet e lëvizshme qe i transferohen Ndërmarrjes se Re janë kryesisht makinat industriale për qepje.

**Ndërmarrja e Re Kosovatrans Stacioni i Autobusëve Ferizaj dhe Kaçanik Sh.P.K.** - operon me dy stacione te autobusëve ne Ferizaj dhe Kaçanik. Tenderi përfshinë te vetmet stacione te autobusëve ne këto dy komuna me infrastrukture, objekte dhe toke te cilat mund t'i përmbushin nevojat e një numri te madh udhëtarësh. Toka e Ndërmarrjes se Re përfshinë përafërsisht 3,240 m<sup>2</sup> ne Ferizaj dhe përafërsisht 4,491 m<sup>2</sup> në Kaçanik.

**Ndërmarrja e Re Kosovatrans Stacioni i Autobusëve Gjilan Sh.P.K.** - përfshinë te vetmin stacion te autobusëve ne Gjilan, me infrastrukture dhe objektet te cilat mund t'i përmbushin nevojat e një numri te madh udhëtarësh. Toka e Ndërmarrjes se Re përfshinë një hapësirë prej përafërsisht 2,000 m<sup>2</sup>, ndërsa objektet ofrojnë përafërsisht 415 m<sup>2</sup> sipërfaqe.

**Ndërmarrja e Re Dyqanet e Çyçavicës në Vushtrri Sh.P.K.** - gjendet afër qendrës në Vushtrri në anën e kundërt të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës dhe ka një sipërfaqe përrreth 119.45 m<sup>2</sup> me dy dyqane në katin përdhes (Dyqani 1: sipërfaqe prej 59.725 m<sup>2</sup>; Dyqani 2: me sipërfaqe prej 59.725 m<sup>2</sup>).

**Ndërmarrja e Re Bujqësia - Toka Bujqësore Dugajevë Sh.P.K.** - i ofron investitorit potencial të blejë toke bujqësore me sipërfaqe prej përrreth 150 ha. të cilat gjinden në Zonat Kadastrale Bokshiq, Dugajeve, Poterq, Jabllanicë dhe Glllogjan të Komunës së Klinës dhe në Komunën e Pejës.

**Ndërmarrja e Re Bujqësia - Tokë Bujqësore Rosulë Sh.P.K.** - e propozuar ndodhet në Komunën e Pejës. Sipërfaqja e tokës në këtë ofertë përfshin rreth 270 hektarë të tokës bujqësore që ndodhen në zonat kadastrale Jabllanicë dhe Rosulë të Komunës së Pejës.

**Ndërmarrja e Re Depo Drenica Sh.P.K.** - me rreth 3.20.40 hektarë (32040 m<sup>2</sup>). Ndërmarrja e Re gjendet në qytetin e Glllogocit fare pranë rrugës kryesore Glllogoc-Skenderaj, zona kadastrale Qikatovë e Re dhe përfshin depot dhe disa pajisje.

**Ndërmarrja e Re Zabeli i Ulët Sh.P.K.** - me rreth 169.28.10 hektarë ( 1692810 m<sup>2</sup>) të tokës bujqësore (nuk ka ndërtesa). Shtrihet në zonat kadastrale; Zabel i Ulët dhe Korroticë e Ulët, shumica e tokave kategorizohet në klasën e 4 dhe ka qasje në ujitje. Shtrihet skaj magjistrales Prishtinë – Pejë.

**Ndërmarrja e Re Kosovaelektro Administrata Sh.P.K.** - ofron lokacion atraktive për afarizëm prej përafërsisht 296m<sup>2</sup> në qendrën e Prishtinës afër Muzeut Kombëtar. Oferta përfshin objektet një-katshe prej përafërsisht 179m<sup>2</sup> me oborrin prej përafërsisht 117m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Zhupa Reçan – Supermarketi në Gornje Selo Sh.P.K.** - përfshinë Supermarketin i cili gjindet në pjesën atraktive të fshatit Gornje Sello, me një sipërfaqe prej përafërsisht 2 ari që përfshinë ndërtesën një katëshe me sipërfaqe totale prej 55m<sup>2</sup> dhe 145m<sup>2</sup> oborr të regjistruara në emër të NSH-së.